

C.Nr. 40/05

Gjykata Komunale e Gllgovcit, si gjykatë civile e shkallës së parë me gjyqtaren e EULEX-it Johanna Schokkenbroek, në kontestin në mes të paditësit Ramiz Isufi nga Qikatova e Re e Gllgovcit, i përfaqësuar nga avokati Zenullah Pirraku dhe të paditurës Komuna e Gllgovcit, e përfaqësuar nga Avokati Publik i Komunës, Hakif Hasi në rastin për kompenzimin e dëmeve nxjerr këtë:

Aktgjykim

1. Kërkesëpadia e paditësit Ramiz Isufi nga Qikatova e Re e Gllgovcit, për kompenzimin e dyqaneve të rrënuara, **APROVOHET PJESËRISHT** dhe e paditura, Komuna e Gllgovcit është e obliguar që t'i kompenzojë dëmet materiale që iu shkaktuan paditësit gjatë rrënimit të dyqanit të tij më 1 dhe 2 mars 2005 (një dyqan në vendin e quajtur "Ashanajka" në Gllgovc, numri kadastral 765 (paditësi nganjëherë i referohet si numri 763), lokacioni numër 23 dhe 24, me sipërfaqe 21,6 m², këtej e tutje i referuar si- dyqani) në një shumë prej 6.480 €, së bashku me kamatën, e cila aplikohet sipas depoziteve bankare për kursime për një periudhë mbi një vit, duke e llogaritur nga data 24 mars 2005, kur ishte ngritur padia e deri në pagesën e fundit.
2. Kërkesëpadia e paditësit Ramiz Isufi nga Qikatova e Re e Gllgovcit për kompenzimin e dyqaneve të dëmtuara, **APROVOHET PJESËRISHT** dhe e paditura, Komuna e Gllgovcit është e obliguar që t'i kompenzojë dëmet materiale që iu shkaktuan paditësit gjatë rrënimit të dyqaneve të tij më 30 mars 2001 në një shumë prej 500 €, së bashku me kamatën, e cila aplikohet sipas depoziteve bankare për kursime për një periudhë mbi një vit, duke e llogaritur nga data 24 mars 2005, kur ishte ngritur padia e deri në pagesën e fundit.
3. Kërkesëpadia e paditësit për kompenzim për fitimin e humbur **REFUZOHET** si e pabazuar.
4. Kërkesëpadia e paditësit për kompenzimin e dëmeve jomateriale **APROVOHET PJESËRISHT** dhe e paditura obligohet që t'i kompenzojë dëmet jomateriale që iu shkaktuan paditësit në një shumë prej 250 €. Kërkesa për kamatë **REFUZOHET**.
5. Kërkesëpadia për kompenzimin e shpenzimeve lidhur me blerjen e tokës për ndërtim konsiderohet si e tërhequr.

E paditura, Komuna e Gllgovcit urdhërohet që t'ia paguajë paditësit Ramiz Isufi shumat nga pika 1, 2 dhe 4 të përmendura më lart, shumën prej 1004 € për mbulimin e shpenzimeve procedurale si dhe

shumën prej 50 € si kompensim për taksën e paguar gjyqësore brenda 15 ditësh pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Arsyetim:

1. Rrethanat e përgjithshme

Në vitin 1992 Komuna e Glllogovcit ua ofroi individëve mundësinë që të marrin ngastra të tokës për ndërtimin e lokaleve afariste në rrugën kryesore të Glllogovcit. Përafërsisht 60 ngastra iu ishin ndarë individëve në vitet që pasojnë. Disa ngastra ishin lëshuar për shfrytëzim të përhershëm. Ngastra të tjera ishin lëshuar për shfrytëzim të përkohshëm. Ngastrat ishin lëshuar me detyrimin që të ndërtoheshin lokale afariste. Kërkohej leja paraprake e Komunës së Glllogovcit për ndërtim. Lokalet ishin ndërtuar në shumicën e ngastrave të lëshuara dhe iu ishin dhënë lejet e punës pas inspektimit të ndërtimit nga Komuna.

Pas luftës (në shtator 1999) Komuna e Glllogovcit vendosi që t'i lirojë ngastrat dhe i urdhëroi të gjithë pronarët individualë të lokaleve që t'i rrënojnë lokalet e tyre dhe ta lirojnë ngastrën.

Procedurat administrative lidhur me këtë vendim të Komunës së Glllogovcit zgjatën deri në vitin 2005, kur Gjykata Supreme në një kontest administrativ më 21 mars 2005 vendosi t'i shfuqizojë vendimet administrative dhe ta kthejë çështjen në procedurë administrative.

Sidoqoftë, para se të bëhej vendimi i Gjykatës Supreme, Komuna më 15 janar 2005 lëshoi një vendim për lirim të ngastrave.

Më 1 dhe 2 mars 2005 Komuna e of Glllogovcit i rrënoi të gjitha lokalet e përfshira në çështje dhe i liroi të gjitha ngastrat.

Vendimet e mëparshme të Komunës së Glllogovcit për rrënimin e këtyre lokaleve ishin suspenduar nga Administratori Komunal i UNMIK-ut (1999) si dhe nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (7 maj 2001) apo ishin ndërprerë për shkak të një kërkesë të Ombudspersonit në Kosovë.

Procedurat administrative lidhur me urdhërat e Komunës së Glllogovcit për heqjen e lokaleve nuk u vazhduan pas rrënimit në mars të vitit 2005. Në atë kohë, pasi që tanimë lokalet ishin rrënuar, nuk ekzistonte gjithashtu objekt për ndonjë procedurë administrative.

Pas rrënimit në mars të vitit 2005 shumë pronarë të lokaleve të rrënuara paraqitën ankesë para Gjykatës Komonale të Glllogovcit kundër Komunës së Glllogovcit për kompensim.

Pasuan procedurat ligjore (ankesat dhe rigjykimet) lidhur me paditë dhe ato zgjatën për shumë vite.

Sipas kërkesës së 19 paditësve / pronarëve të dyqaneve EULEX-i vendosi që t'i merr këto 19 raste (padi për kompensim) me anë të vendimit të datës 8 dhjetor 2009 (17) dhe atë të datës 25 qershor 2010 (2) .

Së paku dy pronarë të lokaleve me kontratë për shfrytëzim të përhershëm të ngastrave të tyre kanë marrë kompensim si rezultat i një vendimi të Gjykatës Komunale të Gllogovcit (në shkallë të dytë të konfirmuar nga Gjykata e Qarkut të Prishtinës).

2. Padia

Ramiz Isufi kërkoi:

1-Kompensim për lokalet afariste të rrënuara (dy dyqane) në një shumë prej 70.000 €,

2 - kompensim për lokalet afariste të rrënuara pjesërisht (dy dyqane) më datën 30 mars 2001 në një shumë prej 15.000 €.

3- Kompensim për fitimin e humbur në një shumë prej 5.000 €,

4- Kompensim për vuajtje morale/ dëme jomateriale në një shumë prej 5.500 €;

5. Kompensim për shpenzimet lidhur me blerjen e tokës ndërtimore në një shumë prej 10. 000 €.

Me anë të parashtresës së datës 14 nëntor 2005 paditësi e ndryshoi padinë e tij dhe e rriti shumën në kërkesëpadi për kompensimin e lokalit afarist të dëmtuar (një dyqan) në një shumë prej 60. 000 € (1). Gjatë shqyrtimit kryesor (fjalës përfundimtare) paditësi e ndryshoi shumën e kërkuar nën 1 në një shumë prej 70. 000 €.

Gjatë shqyrtimit kryesor (fjalës përfundimtare) paditësi e ndryshoi kërkesën e tij dhe e zvogëloi shumën e kompensimit për dyqanin e rrënuar pjesërisht më 30 mars 2001 (2) në një shumë prej 5. 000 €.

Gjatë shqyrtimit kryesor (fjalës përfundimtare) paditësi e ndryshoi kërkesën e tij dhe e rriti shumën për kompensim për fitimin e humbur (3) në një shumë prej 60.000 €.

Gjatë shqyrtimit kryesor (fjalës përfundimtare) paditësi e ndryshoi kërkesën e tij dhe e rriti shumën për kompensim për vuajtje morale/ dëme jomateriale (4) në një shumë prej 15.000€.

Gjatë seancës kryesore (fjalës përfundimtare) paditësi e tërhoqi padinë lidhur me kompensimin për shpenzimet lidhur me blerjen e tokës ndërtimore (5).

Paditësi e bazon padinë e tij në faktin se me dëmtimin dhe rrënimin e pronës së tij Komuna e Glllogovcit e ka shkelur Ligjin. Paditësi kërkon kompensim për shpenzime procedurale në një shumë prej 2500 € (gjatë shqyrtimit kryesor (fjalës përfundimtare) paditësi e ndryshoi shumën e kërkuar në një shumë prej 3.000 €).

Komuna e Glllogovcit e mban qëndrimin se ajo kishte plotësisht te drejtë që t'i lironte ngastrat (duke e përfshirë rrënimin e dyqanit) dhe se nuk e kishte shkelur asnjë ligj, pasi që kontrata e nënshkruar në mes të palëve e parashihte që Komuna mund të kërkojë nga pronarët që t'i heqin lokalet e tyre, nëse kërkohej nga Komuna. E paditura kërkoj kompensimin për shpenzime procedurale në një shumë prej 711 €.

3. Historia procedurale

Padia ishte ngritur para Gjykatës Komunale të Glllogovcit më 24 mars 2005. Më 14 nëntor 2005 Gjykata Komunale e Glllogovcit vendosi që ta ndërprejë procedurën të mbetur pezull në procedurë administrative para Drejtoratit Komunal për Planifikim Urban, apo kur gjykata ta konsideronte si të përshtatshme vazhdimin e procedurës (C. nr. 40. 05).

Në këtë rast, Gjykata Komunale e Glllogovcit asnjëherë nuk ka lëshuar një aktgjykim

Më 26 nëntor 2009, paditësi kërkoj nga EULEX-i që ta mirrte rastin.

Më 25 qershor 2010, EULEX-i e mori përsipër rastin për rigjykim. Më 5 maj 2010, procedura u ndërpre me qëllim që të informohej Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave ashtu siç kërkohej me nenet 67 dhe 68 të Ligjit mbi Menagjimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Në rigjykim, u mbajtën seanca përgatitore dhe seanca kryesore, ashtu siç përshkruhet në procesverbalin e këtyre shqyrtimeve gjyqësore.

4. Faktet

Gjykata i referohet provave të administruara ashtu siç janë regjistruar në procesverbalin e shqyrtimeve gjyqësore.

Faktet e mëposhtme lidhur më këtë lëndë janë vërtetuar apo sidoqoftë janë të pakontestuar:

Në vitin 1997 Komuna e Gllgovcit ia dha paditësit një ngastër të tokës për shfrytëzim të përkohshëm në vendin e quajtur Ashanajka, parcela kadastrale nr. 765, nr. 23 dhe 24 në Komunën e Gllgovcit me një sipërfaqe prej 22 m². Paditësit iu ishte ndarë ngastra e tokës ndërtimore nën detyrimin e ndërtimit të një objekti (dyqani) në këtë ngastër. Nëse paditësi nuk do ta ndërtonte dyqanin brenda një viti ai do të humbte të drejtën për shfrytëzimin e ngastrës. Për ndërtimin e dyqanit duhej të plotësoheshin kushtet ndërtimore të vendosura nga Komuna e Gllgovcit dhe kërkohej leja paraprake për ndërtim.

Ishte theksuar nga Komuna e Gllgovcit se ky organ ka fuqinë që të urdhërojë paditësin që ta lirojë ngastrën (që do të thotë ta largojë dyqanin e ndërtuar) për arsye të shfrytëzimit urban brenda një afati të caktuar nga Komuna e Gllgovcit. Në rast se paditësi nuk do t'i përmbahej këtij afati, Komuna e Gllgovcit do të mund ta bënte lirimin e ngastrës me shpenzimet e paditësit.

Komuna e Gllgovcit kishte urdhëruar se e drejta për shfrytëzimin e ngastrës ishte individuale dhe ajo nuk mund t'iu bartej palës së tretë apo t'iu dorëzohej palës së tretë.

Gjykata iu referohet provave të administruara të paraqitura nga palët:

- Vendimi i Komunës së Gllgovcit (Departamenti per Planifikim Urban, Banim, Infrastrukturë Komunale dhe Pronë) i datës 23 maj 1997;
- Kontrata e datës 27 maj 1997;
- Vendimi i Komunës së Gllgovcit i datës 2 qershor 1997 për dhënien e lejes për ndërtimin e lokalit afarist.

Lokali afarist (një objekt i përbërë nga dy kate me nga një dyqan në secilin kat) ishte ndërtuar dhe shfrytëzuar për qëllime ekonomike për disa vite. Dyqani ka një sipërfaqe prej 21.6 m² (6.00 x 3.60 m²).

Më 30 mars 2001 Komuna e Gllgovcit kishte për qëllim që ta rrëronte dyqanin e paditësit (dhe lokalet e pronarëve të tjerë të dyqaneve). Për shkak të intervenimit ligjor të Administratorit Regjional të Prishtinës Komuna e Gllgovcit ishte urdhëruar që ta ndërprente aktin e rrënimit. Dyqanet e paditësit ishin rrënuar pjesërisht.

Më 5 maj 2004 dhe 19 shtator 2004 Komuna e Gllgovcit mori vendime, me të cilat e anuloi vendimin për ndarjen e tokës për paditësin (dhe për pronarët e tjerë të dyqaneve).

Paditësi nuk u pajtua me këtë vendim dhe e kontestoi vendimin përmes procedurave të natyrës administrative (siç bënë edhe shumë pronarë të tjerë të dyqaneve).

Më 21 mars 2005 Gjykata Supreme vendosi që ta shfuqizojë vendimin e Ministrisë për Ambient dhe Planifikim Hapësinor të datës 19 tetor 2004 dhe ta kthejë çështjen në rigjykim. Ky vendim i Gjykatës Supreme ishte vendimi i fundit në procedurë administrative lidhur me vendimin e Komunës së Glllogovcit për lirim të ngastrave.

Më 1 dhe 2 mars 2005 Komuna e Glllogovcit i rrënoi të gjitha lokalet e përfshira dhe i liroi të gjitha ngastrat. Ky rrënim u bë pa një njoftim paraprak për paditësin (dhe për pronarët e tjerë të dyqaneve).

Së paku dy pronarë të lokaleve me kontratë për shfrytëzim të përhershëm të ngastrave të tyre kanë marrë kompenzim si rezultat i një vendimi të Gjykatës Komunale të Glllogovcit të datës 16 mars 2007 (C.nr 78/05) dhe 21 Shtator 2007 (C.nr 95/05). Komuna e Glllogovcit paraqiti ankesë ndaj të dyja vendimeve. Gjykata e Qarkut të Prishtinës i konfirmoi këto vendime me anë të vendimeve të datës 30 prill 2008 (AC.nr 445/2007) dhe 15 qershor 2009 (AC.937/2007). Në rastin e parë të theksuar më lart pronari i dyqanit mori një kompenzim prej 282 € për m² dhe pronari tjetër i dyqanit mori 540,82 € për m².

5. Çështjet procedurale të ngritura nga palët

Parashtresat:

A) Moskompetenca e gjykatës

Në një parashtresë Komuna e Glllogovcit e kundërshtoi kompetencën e Gjykatës dhe kërkoi nga Gjykata që ta hedhë poshtë padinë në bazë të moskompetencës së Gjykatës. Sipas Komunës së Glllogovcit, autoriteti kompetent për kontestet administrative është Gjykata Supreme.

Gjykata është e mendimit se ky është një kontest rreth përgjegjësisë për dëmet. Këto dëme janë rezultat i një veprimi të Komunës së Glllogovcit që ka ndodhur në Glllogovc.

Në bazë të nenit 47 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, gjykata kompetente është Gjykata në territorin e së cilës ka ndodhur dëmi.

Gjykata e hodhi poshtë kundërshtimin e Komunës së Glllogovcit si të pathemeltë. Gjykata iu referohet një vendimi të ngjashëm të parashtruar nga Komuna e Glllogovit në një fazë të mëhershme të këtij kontesti.

B) Moskompetenca e EULEX-it

Në një parashtrësë Komuna e Glllogovcit e kundërshtoi kompetencën e EULEX-it, pasi që ky kontest nuk ka të bëjë me pronën.

Kjo Gjykatë (kjo gjyqtare e EULEX-it) është e mendimit se ky kontest është çështje civile që ka të bëjë me pronën, ashtu siç shprehet në nenin 5.1 c. të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.

C) Kundërshtimi lidhur me Nenin 394 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore

Në një parashtrësë tjetër Komuna e Glllogovcit bëri një vërejtje lidhur me rregullsinë e procedurave, duke pretenduar që është dashur që Komunës së Glllogovcit t'iu ishte dhënë mundësia që të parashtrojë një përgjigje me shkrim në padi, në pajtim me nenin 394 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK). Gjykata nuk ka kërkuar nga Komuna e Glllogovcit që të paraqesë përgjigje në padi, për shkak të faktit se neni 394 i LPK-s kërkon nga Gjykata që të kërkojë nga pala e paditur përgjigje në padi, "brenda 15 ditësh pasi që gjykata ta ketë pranuar padinë". Në rastin konkret, është e qartë se kjo nuk ishte e realizueshme, për shkak të faktit se padia ishte dorëzuar në Gjykatë në vitin 2005, kur kjo dispozitë procedurale që kërkonte përgjigje në padi nuk ishte në fuqi. Përveç kësaj, pasi që rasti konkret ishte rigjykim dhe palët tanimë i kishin dhënë qëndrimet e tyre në procedurat e mëhershme dhe nga këto qëndrime ishte e pamundur që të veprohej në pajtim me nenet 398 apo 399 të LPK-s, Gjykata nuk pa ndonjë përfitim substancial që të kërkonte përgjigje në padi nga pala e paditur 5 vite pas dorëzimit të padisë dhe pas shqyrtimeve në dy instanca. Prandaj, kjo vërejtje e palës së paditur nuk është marrë parasysh.

D) Kundërshtimi lidhur me ndryshimin e padisë

Në një parashtrësë tjetër Komuna e Glllogovcit bëri një vërejtje lidhur me ndryshimin e padisë nga ana e paditësit në fazën e fjalës përfundimtare. Gjykata e pranon/ aprovon këtë parashtrësë për sa ka të bëjë me rritjen e shumës në padi. Në bazë të nenit 258 të LPK-s ndryshimi duhet të bëhet para fillimit të seancës kryesore.

Kështu që ndryshimi i padisë që ka të bëjë me rritjen e shumës në padi pika 3 (kompenzimi për fitimin e humbur në një shumë që fillimisht ishte 5.000 € u rrit në një shumë prej 60.000 €) dhe 4 (kompenzimi për vuajtjet morale/ dëme jomateriale që fillimisht ishte në një shumë prej 5.5000 €, u rrit në një shumë prej 15.000 €) do të neglizhohet nga Gjykata.

Sidoqoftë, ndryshimi i padisë që ka të bëjë me pikën 5 (Kompenzim për shpenzimet lidhur me blerjen e tokës ndërtimore në një shumë prej 10.000 €), e cila kërkesë nuk ishte përfshirë gjatë

fjalës përfundimtare, do të pranohet nga Gjykata, pasi që është e mundshme që të tërhiqet padia pjesërisht në të gjitha fazat e procedurës. Prandaj, Gjykata e konsideron këtë pjesë të padisë si të tërhequr.

6 Vlerësimet ligjore sipas fakteve

Kërkesa 1 (si rezultat i rrënimit në vitin 2005)

Kjo padi ka të bëjë lidhur me pronën e dëmtuar (shkatërruar) (një dyqan).

Është e pakontestueshme se Komuna e Gllgovcit e obligoi paditësin që të bënte një investim (që do të thotë të ndërtonte një dyqan në atë ngastër).

Është e pakontestueshme se paditësi ndërtoi një lokal dhe ishte pronar i atij lokali (dyqani) të ndërtuar në këtë ngastër dhe i inventarit të tij.

Është e pakontestueshme se shfrytëzimi i ngastrës ishte i natyrës së përkohshme. Komuna e Gllgovcit kishte të drejtë që ta ndërprente shfrytëzimin e ngastrës vetëm për arsye të planifikimit urban. Mund të konkludohet nga dokumentet e paraqitura se Komuna e Gllgovcit ishte e obliguar që ta lejonte pronarin që ta lironte ngastrën dhe të shpallte një afat para se të bëhej lirimi i pronës nga Komuna e Gllgovcit.

Prej vitit 1999 Komuna e Gllgovcit mori disa vendime, të gjitha kishin për qëllim që ta lajmëronin paditësin (dhe pronarët e tjerë të dyqaneve) që ta lironin ngastrën.

Paditësi (si shumë pronarë të tjerë të dyqaneve) i kontestoi vendimet e Komunës së Gllgovcit që e detyronin atë që ta lironte ngastrën (me arsyetimin e mungesës së nevojës për planifikim urban). Këto procedura administrative asnjëherë nuk u përfunduan. Pra, asnjëherë nuk është vërtetuar me një vendim gjykatë të formës së prerë, nëse Komuna e Gllgovcit kishte të drejtë që të vendoste për ndërprejen e kontratave për ngastrat dhe të vendoste për lirimin e tyre. Sidoqoftë, kjo Gjykatë nuk hyn në çështje ligjore administrative, apo në kontest administrativ, e cila nuk është nën kompetencat e kësaj gjykatë.

Në atë kohë (1 dhe 2 mars 2005) ishte në fuqi Rregullorja mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut 2000/ 45).

Kjo rregullore përmban një kapitull "Ekzekutimi i Çështjeve Komunale"(kapitulli 5 Neni 33).

Ky kapitull përmban këtë dispozitë të cituar:

“Parimet e Ligjshmërisë

Ligji dhe drejtësia e obligojnë administratën e komunës që të zbatojë në veçanti të drejtat dhe liritë e njeriut sipas Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.”

Protokolli nr. 1 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore thotë, siç vijon:

Neni 1

Mbrojtja e pronës

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk çenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.

Gjatë ushtrimit të këtij pushteti që ka për qëllim interesin e përgjithshëm të cituar më lart, shteti apo çfarëdo organi administrativ, duke qenë pjesë e shtetit (siç është në këtë rast Komuna e Gllgovcit), është i obliguar që t’i bindet ligjit dhe drejtësisë. (neni 33 i Rregullores mbi Vetqeverisjen e Komunave në Kosovë/ Rregullorja e UNMIK-ut 200/ 45).

Bile edhe kur Komuna e Gllgovcit e ushtroi pushtetin e saj në pastrimin e ngastrave në mënyrë të duhur ligjore (e cila asnjëherë nuk është vërtetuar pasi që procedurat administrative asnjëherë nuk u përfunduan), Komuna e Gllgovcit ka për obligim që t’i kompenzojë pronarët e dyqaneve për humbjen e investimeve të tyre bazuar në parimin e përgjithshëm të drejtësisë. Ky obligim është i rëndësishëm sidomos në këtë situatë kur është e pakontestueshme se Komuna e Gllgovcit e ka obliguar shfrytëzuesin e ngastrës që ta ndërtojë dyqanin në ngastër.

Gjatë ushtrimit të këtij pushteti, që kishte për qëllim interesin e përgjithshëm, nënkuptohet parimi i drejtësisë e që organi administrativ duhet t’i merr parasysh interesat e personave që janë të përfshirë në këtë çështje.

Gjykata konkludon se Komuna e Gllgovcit gjatë ekzekutimit të pushtetit të saj fare nuk i ka marrë parasysh interesat e pronarëve të dyqaneve që ishin të përfshirë në këtë çështje.

Së pari Komuna e Gllgovcit nuk e shpalli një afat para të cilit duhej të liroheshin ngastrat dhe nuk e shpalli datën se kur vet Komuna e Gllgovcit do t’a lironte ngastrën (shkatërronte lokalitetin). Gjykata konsideron se në këtë rast të veçantë nuk ka pasur urgjencë që të ekzekutohet vendimi për lirimin e ngastrës para një dite të caktuar (sidoqoftë Komuna e Gllgovcit nuk ka zbuluar

ndonjë rrethanë të kësaj natyre dhe gjykata nuk ka mundur të konkludojë ndonjë prej rrethanave të tilla nga dokumentet e parashtruara).

Përveç dispozitës në kontratë, parimet e përgjithshme të drejtësisë nënkuptojnë gjithashtu që organi administrativ, gjatë ekzekutimit të pushtetit për lirimin e ngastrës me qëllim të interesit të përgjithshëm duhet të bëjë përpjekje për zvogëlimin e dëmit të mundshëm ndaj pronarëve të dyqaneve (padiësit). Në këtë rast të veçantë Komuna e Glllogovcit është dashur që t'i njoftojë të gjithë pronarët e dyqaneve me kohë se Komuna e Glllogovcit do t'i lirojë vet ngastrat, nëse ata vet nuk i lirojnë ato (me shkatërrimin e të gjitha lokaleve të mbetura).

Gjatë seancës kryesore saktësisht u kuptua se Komuna e Glllogovcit nuk ka shpallur një (ndonjë) afat kohor para se të ndodhte rrënimi i dyqaneve më 1 dhe 2 mars 2005. Është e pakontestueshme se rrënimi më 1 dhe 2 mars 2005 ishte i papritur për pronarët e dyqaneve. Nga dokumentet e parashtruara nga palët konstatohet se Komuna e Glllogovcit nuk ka dërguar ndonjë njoftim (me anë të konkluzioneve, letrave, vendimeve, etj.) pas vitit 2002. Gjykata konstatoi nga raporti i parashtruar nga Ombudspersoni se disa prej pronarëve të dyqaneve ishin të njoftuar lidhur me qëllimin e Komunës së Glllogovcit për lirimin (domethënë shkatërrimin) në të ardhmen e afërt. Sidoqoftë, Gjykata konstaton se Komuna e Glllogovcit nuk e ka informuar padiësin në kohë dhe mënyrë të duhur lidhur me ditën që ishte e caktuar për rrënim. Me rezultatin se padiësit iu ishte mohuar mundësia për largimin e pronës së tij.

Prandaj, shkatërrimi i dyqaneve më 1 dhe 2 mars 2005 nga ana e Komunës së Glllogovcit është një shkelje e qartë e të drejtave pronësore të padiësit për lokalin që i përkiste atij dhe prandaj duhet të kompenzohet.

Dëmi dhe kompenzimi:

Rrënimi ndodhi më 1 dhe 2 mars 2005. Do të thotë para më shumë se gjashtë vitesh. Nuk ka mbetur asgjë nga dyqanet e mëparshme. Tani është e pamundur që të vërtetohet shuma e saktë e dëmit të shkaktuar me rrënimin. Kështu që eksperti nuk do të mund të ndihmonte në vërtetimin e dëmit. Humbja e provave lidhur me dëmin është një rezultat i drejtpërdrejtë nga rrënimi i përgjithshëm i papritur i dyqaneve. Këto rrethana janë tërësisht në rrezik dhe në shpenzime të Komunës së Glllogovcit. Lartësia e dëmit është e bazuar në parimet e përgjithshme të drejtësisë dhe përgjegjshmërisë. Shuma e kompenzimit do të bazohet në m2 kati përdhesë (200 €) dhe m2 hapësira nënkulm (100 €). Gjykata aprovon padinë për dyqanin e shkatërruar deri në shumën 6.480€ (21.6 m2).

Për këtë, gjykata ka llogaritur shpenzimet e përafërta lidhur me ndërtimin në kohën kur u bë ndërtimi dhe jo vlerën komerciale të dyqanit, sepse në bazë të kushteve të zbatueshme në mes të palëve, shfrytëzuesi nuk ka pasur të drejtë që ta shesë lokalin.

Kërkesa 2 (kërkesa si rezultat i rrënimit të pjesërishtëm në vitin 2001)

Kjo kërkesë ka të bëjë me kompensimin për dëmin që iu shkaktua të njëjtit dyqan nga ana e Komunës së Glllogovcit. Sidoqoftë kjo kërkesë ka të bëjë me ngjarjet e 30 marsit të vitit 2001. Gjykata i referohet arsyetimit në kërkesën 1 (përveç dy paragrafeve të fundit). Komuna e Glllogovcit nuk e konteston se ajo e ka shkaktuar dëmin. Dëmi ishte shkaktuar para më shumë se 10 vitesh. Sipas qëndrimit të paditësit, ai e kishte riparuar dëmin. Tanimë nuk është e mundur që të vërtetohet lartësia e saktë e dëmit të shkaktuar nga Komuna e Glllogovcit. Kështu që eksperti nuk do të mund të ndihmonte asgjë në vërtetimin e dëmit. Paditësi nuk ofroi anjë specifikacion, dokument apo fotografi të dëmit të shkaktuar. Sidoqoftë është evidente (dhe jokontestuese) se paditësi ka pësuar dëme. Gjykata e aprovon kërkesën për dyqanin e dëmtuar në një shumë simbolike prej 500 €.

Kërkesa 3 (kompensimi për fitimin e humbur)

Procedurat administrative lidhur me urdhërat e Komunës së Glllogovcit për lirimin e lokaleve nuk u vazhduan pas rrënimit në mars të vitit 2005. Kjo është rrjedhojë e mungesës së iniciativës së të dyja palëve të përfshira.

Pasi që çështja e ligjshmërisë për ndërprerjen e kontratës varet nga një vendim në procedurë / kontest administrativ dhe kjo gjykatë është jokompetente për të vendosur lidhur me këtë, kjo Gjykatë nuk mund të vërtetojë përgjegjësinë për dëmet që rrjedhin nga përfundimi i veprimtarive afariste në dyqanet e dëmtuara dhe prandaj, kjo kërkesë refuzohet si e pabazuar.

Kërkesa 4 (kompensimi për vuajtjet shpirtërore/ dëmet jomateriale)

Është e qartë se kjo ngjarje i shkakton paditësit vuajtje shpirtërore/ dëm jomaterial. Për shumicën e pronarëve të dyqaneve kjo do të thotë humbje e burimit të të hyrave të tyre për jetesë. Nga natyra e saj ky lloj dëmi nuk mund të kompensohet me anë të parave dhe dëmi as nuk mund të caktohet saktësisht. Prandaj, gjykata e aprovon një kompensim simbolik në një shumë prej 250 €. Nuk ekziston bazë ligjore që të aprovohet kamata e kërkuar pasi që shuma e kompensimit është llogaritur nga dita e sotme.

Kërkesa 5 (Kompensim për shpenzimet lidhur me blerjen e tokës ndërtimore)

Duke iu referuar arsyetimit nën 5 pika F, Gjykata e konsideron këtë kërkesë si të tërhequr. Kështu që nuk ka nevojë që të vendoset lidhur me këtë kërkesë.

7 Shpenzimet procedurale

Edhe pse kërkesëpatria është aprovuar vetëm pjesërisht, gjykata ka vendosur në pajtim me Nenin 452. 3 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore që pala e paditur do t'i bartë të gjitha shpenzimet procedurale. Kjo ishte vendosur për shkak të faktit se veprimet e palës së paditur sollën deri të kontesti. Ky kontest kishte mundur të shmangej sikur e paditura të kishte treguar vullnet për arritjen e një marrëveshjeje me paditësen për kompenzimin e dëmeve. Pozita e të paditurës si autoritet publik duhet të mirret parasysh si një obligim shtesë për pajtim me qytetarët dhe t'i kushtojë vëmendje të drejtave të tyre pronësore të ligjshme. Gjkata nuk ka vërejtur ndonjë lloj të një vullenti të tillë nga ana e të paditurës. Prandaj, gjykata vendosi, sipas detyrës zyrtare, që shumën prej 1004 € - shpenzimet procedurale e paditura duhet t'ia paguajë paditësit.

**Gjkata Komunale e Gllogovcit,
C.Nr 40/05, data 27 shtator 2011**

**Gjyqtarja e EULEX-it
Johanna Schokkenbroek**

8 Këshilla juridike

Palët mund të paraqesin ankesë ndaj këtij aktgjykimi drejtuar Gjykatës së Qarkut të Prishtinës përmes kësaj gjykate, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi.

E përpiluar në anglisht si gjuhë e autorizuar.